



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **15**

Prishtinë, më 27.5.2015, ora 10,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Emilija Redzeqi, Adem Salihaj, Shaip Muja, Salih Salihu, Haxhi Shala, Lahi Brahimaj, Srdjan Popovic.

Mungoi : Murat Hoxha.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë : sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi, Dalina Kërqeli.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 19.5.2015,
3. Shqyrtimi i problemeve rreth qumështit dhe patates me përfaqësues të këtyre prodhimeve,
4. Raportimi nga Kryeshefi i agjencisë pyjore rreth çështjeve të mirëmbajtjes së pyjeve të Kosovës,
5. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime, dhe u sugjeruan disa nënpika për pikën e fundit.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.5.2015

Kryetari i Komisionit konstatoi miratimin e komisionit për procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

3. Shqyrtimi i problemeve rreth qumështit

Kryetari përshëndeti zyrtarët e shoqatës së qumështoreve të Kosovës dhe kryetarin **Ramadan Memaj** i cili falënderoj për ftesën dhe qysh në fillim potencoi se çështjet përkatësisht problemet me qumështin në Kosovë janë si pasojë e : 1. Konkurrencës së padrejtë dhe jo lojale, 2. moszbatimit të ligjit dhe 3. Keqpërdorimi i parasë publike. Ai njoftoi komisionin me strukturën e shoqatës dhe grumbullimin e qumështit në Kosovë që mbulon 55% të nevojës vendore. Në mungesë të zbatimit të ligjit nga ana e AUV dhe MTI të cilat lejojnë produktet pa deklarime të hyjnë në Kosovë sipas rregullores nr. 218 (kjo rregullore lejon edhe produktet që nuk kanë përmbajtje të qumështit), buxheti vendor dëmtohet në masën e konsiderueshme dhe njëherit rrezikon shëndetin e popullatës për shkak se janë produkte jo të testuara dhe të analizuara dhe nuk konsiderohen produkte të qumështit, sidomos nëse përmbajnë yndyra bimore të cilat nuk janë për konsum (bllokojnë enët e gjakut, rrisin tensionin dhe infarktët). Industria vendore e qumështit nuk ka si të jetë me perspektivë përballë një realiteti të tillë ngase përpunuesit vendorë nuk mund ti bëjnë ballë një konkurrence të tillë krejtësisht të pabarabartë. Në vendet e BE produktet me përmbajtje të yndyrave të kontrolluara bimore kanë një trajtim të veçantë për mënyrën e shitjes së tyre, vendin e ekspozimit, etiketimit, informimit, madhësia e shkronjave të deklarimit në rast se kanë yndyra bimore etj, gjë që nuk ndodhë në vendin tonë. Kryetari pyeti komisionin a nuk është shkelje ligjore të shitet diçka tjetër në vend të djathit ku shkelet e drejta e prodhuesve vendorë për të qenë përfitues dhe konkurrues me çmim. AUV , vazhdoi ai, gjatë vitit 2014 nxori ndalesën e importit të 5 produkteve nga disa vende, por ato ende gjenden në tregun tonë. Ai shtoi se AUV punon vetëm sa për kozmetikë ngase asgjë nuk ndryshon edhe pse vepron ajo, përpjekjet janë të kota, bile si tha ai punohet sipas parimit “kot e keni çkado që të veproni” dhe propozoi urgjentisht si vijon :

- Ndalimin e produkteve me përmbajtje yndyrore bimore,
- Vendosijen e taksës specifike në produkte të tilla nëse lejohet importi,
- Zbatimin e ligjit lidhur me mënyrën e shitjes së produkteve të tilla dhe
- Ndalimin e shitjes së produkteve të tilla, kurse në fazën tjetër
- Formimin e komisionit ndërministror në bashkëpunim me shoqatat,
- Formimin e një platforme kombëtare për siguri ushqimore

Kryetari Fikrim Damka kërkoi sqarim lidhur me vendimin e cekur të AUV për ndalesën e disa produkteve, kurse kryetari z. Memaj tha se ato produkte nuk dihet çfarë përbëjnë ngase nuk ka analiza. **Lahi Brahimaj** pyeti për emrat e kompanive që importojnë përkundër ndalesës së AUV. **Emilija Redzepe** gjithashtu potencoi problemin e qëndrimit të këtyre produkteve ende në tregun tonë. **Adem Salihaj** tha se mjaft interesante ishte kjo që dëgjoi sot komisioni dhe pyeti për vendet ku gjenden fabrikat prej nga janë ndaluar produktet dhe a shesin ato edhe në vende tjera, gjithashtu pyeti a ka kjo shoqatë edhe probleme tjera të brendshme, në mënyrë që ky komision të përgadit rekomandime për Qeverinë dhe Kuvendin. Z. Memaj tha se 2 janë nga Hungaria, 2 nga Bullgaria dhe 1 nga Maqedonia, ndërsa për pjesën tjetër të pyetjes tha se kryesore është problemi i produkteve të cekura të cilat kontribojnë që problemet tjera të janë më të vogla për prodhuesit vendorë, për pyetjen e z. Lahi tha se ata janë kryesisht ETC, Gllareva, Delfin, Coral etj të cilat zënë edhe hapësirën tonë të çmueshme. **Haxhi Shala** pyeti për protesta të qumështarëve të cilat janë ndalur, pse, si dhe a përfaqëson kjo shoqatë fermerët apo edhe fabrikat. **Ramadan Memaj** tha se të njëjtit kanë dashur të zgjedhin problemet në mënyrë institucionale dhe falënderoj që ky komision është hap për këtë shoqatë, por potencoi se fatkeqësia është që kërkesat e tyre vazhdojnë të paragjykojnë, gjithësesi, vazhdoi, parlamenti duhet ti diskutoi këto probleme e jo të minimizohen gjërat dhe krijohen stoqet, prandaj edhe fshatarët detyrohen të derdhin qumështin. **Salih Salihu** potencoi tri shkaqet e cekura të problemeve me qumështin, ndaj si komision cekur se duhet të ngrisin problemin në Kuvend ngase nuk dihet çka mund të ndodhë më tutje në familjet tona ku konsumohen produktet e cekura, pyeti si është vërtetu origjina bimore. Z. Memaj tha se problemi është zbutur me rastin e ndërrimit të tiketave por nuk është tërheq malli, pra ato produkte nuk janë ndaluar asnjëherë. AUV duhet të jap licencën një prodhuesi. Lidhur me origjinën bimore tha se në tiket shkruhet vetëm yndyrë

p.sh. 40% por çfare nuk ceket. Lidhur me pyetjen se kend e përfaqëson kjo shoqatë, tha se përfaqëson edhe prodhuesit. Ndërhyri z. **Shala** i cili tha se protestuesit kanë thënë se janë të mashtruar. Këto janë paragjykimet dhe dezinformatat që fola unë, tha z. Memaj. **Shaip Muja** tha se duhet të shikohen shumë gjëra siç janë, mënyra e granteve sa janë bazuar në ligj dhe a plasohen deri në destinacion, çka janë hendikepet e qumështarëve (përveç vajtimeve), cilët faktorë pengojnë paraqitjen në treg të qumështarëve vendorë,, udhëzimet për ndryshimin e yndyrës etj përndryshe e turpshme është të shohim si derdhet qumështi, kërkoi nga kjo shoqatë të shikojnë edhe Ligjin anti damping dhe dispozitat e CEFTËS si rregullon këto çështje, nëse ka shkelje sipas tyre, atëherë të vepohet dhe sidomos në cilat pika (nene) preket siguria e ushqimit, ai kërkoi nga komisioni një takim më të zgjeruar ku do të ftohen 4 ministra : ai i MSH, MTI, MB dhe MMPH ngase të katërt duhet të kontribuojnë në eliminimin e pengesave dhe të bashkohen fermerët përmes edukimit të tyre, në fund të shihet se a duhet ma tepër përpjekje nga shteti apo nga fermerët, përkrahjen do ta keni 100% , përfundoi duke ju drejtuar kryetarit të shoqatës. Në përfundim **Lahi Brahimaj** apeloi në ndalimin e veprimeve ilegale dhe produkteve ilegale, ndërsa u kërkua edhe një dëgjim publik ose çfarëdo veprimi nga ky komision që do të garantojë syqeltësinë e shtetit lidhur me këtë problematikë, ndaj edhe **Fikrim Damka/Kryetar** premtoi qumështarëve se me kaq kjo çështje nuk mbaron por komisioni do të vazhdoi me përpjekje të vazhdueshme derisa të zgjidhet çështja e qumështit në Kosovë, sidomos stimulimi i prodhimit vendor. Për veprimet e mëtejme do të njoftohet edhe shoqata në vazhdimësi.

4.Raportimi nga Kryeshefi i agjencisë pyjore rreth çështjeve të mirëmbajtjes së pyjeve të Kosovës

Kryetari falënderoi mysafirët e ftuar nga APK përfaqësuar me kryeshefin **Ahmet Zejnullahu** dhe kërkoi nga ai të potencoi problemet kryesore, ngase deri tani shumë përpjekje janë bërë për mbrojtjen e pyjeve, sidomos edhe në legjislacionin e kaluar, kur janë miratuar nga seanca plenare rekomandimet dhe është kthyer në Qeveri projektligji për pyjet. Kryeshefi i APK z. Zejnullahu në fillim njoftoi se projektligji i hartuar bashkërisht me akterët kryesorë, tani gjendet në Qeveri dhe pritet dërgimi në Kuvend, dhe shtoi se pyjet e Kosovës, nga të cilat 60% janë shtetërore, janë inventarizuar nga APK më 2013 dhe vazhdimisht kemi shtim të pyllëzimit me 20.000 ha më tepër sesa që ka pasur më 2003, gjithashtu edhe pyjet e xhveshura të cilat pyllëzohen 400 ha në vit me masë drunore. Sa i përket përgjegjësisë, nga viti 2010 është nxjerr ligji i cili menaxhimin ja kalon autoriteteve komunale ku bëjnë pjesë rojet, teknikët, shitjen etj. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për PK Bjeshkët e Nemuna dhe Sharr, vazhdoi, janë paraqitur vështirësi në zbatimin e ligjit, paqartësi dhe dilema rreth kompetencave, pasi Neni 7 i Ligjit për Pyje thotë se APK menaxhon edhe me parqe nacionale ku janë pyjet, të cilat kanë kapacitete për industrinë e përpunimit të drurit dhe furnizimin e qytetarëve me dru për ngrohje. Në vazhdim ai paraqiti faktet rreth mbrojtjes nga prerjet ilegale të pyjeve, kundër zjarreve në pyje dhe kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve duke saktësuar fletparaqitjet penale, angazhimin e 120 puntorëve për 4 muaj kur ndodhin zjarret më shpesh dhe duke hartuar ekspertizën kombëtare për shëndetin pyjor të Kosovës, për fidanet në Institutin e pylltarisë në Pejë dhe pyllëzimin e sipërfaqeve të xhveshura.

Adem Salihaj kërkoi edhe anën negative të këtij raportimi, ngase nuk u kuptua sa janë të dëmtuara në vit pyjet në Kosovë. Përgjigje të sakt nuk kishte nga z. Zejnullahu, ngase nuk dihet dëmtimi, dihet vetëm ajo që, aty ku ka dëmtim vazhdimisht bëhet pyllëzimi-rigjenerimi. Gjithashtu edhe **Lahi Brahimaj** tha se terreni tregon krejtësisht diçka tjetër nga ajo çka u tha në raportim (më hollësisht tregoi për dëmet në Jabllanicë të Gjakovës nga posedon edhe shumë fotografi, në Kërpimëh) dhe tha se ska kush që i ndalon, pyeti sa ka qasje APK në veri të vendit. Kryeshefi sërish përsëriti se kompetencat 28% të APK nuk lejojnë influencë më të madhe të APK/së dhe potencoi veprimet e ndërmarra nga APK përmes fletdenoncimeve etj. **Adem Salihaj** tha se delegimi është bërë sa i përket punëve të APK por përgjegjësia është e APK, megjithatë. Na të gjithë blejmi “dru të vjedhura”, vazhdoi, por megjithatë duhet të njoftohemi sa ofron APK

“drunj ligjorë”. Përgjegja nga kryeshefi ishte se ligji është i pamundur të zbatohet dhe se APK nuk ka përgjegjësi direkte. Në vazhdim kishte pyetje dhe ndërhyrje nga **Shaip Muja, Lahi Brahimaj, Emilija Redzeqi, Salih Salihu** në kuptimin e gjendjes alarmante në pyjet e anës së Dukagjinit, Dragashit, Karadakut (përpunimi i breketit dhe peletit, lëvizja e metanit dhe shkaktimi i zjarreve, raportimi pa ministrin e dikasterit përkatës) etj dhe për mos me parashtrur shumë pyetje, unanimisht u kërkuar përgjegje me shkrim nga APK ti sjell komisionit ngase si tha **Shaip Muja** APK ka mbetur si jetime “për shkak se i ka dy bosa” dhe nuk din kend ta dëgjoi ma tepër. Kundërshtoi **Haxhi Shala** dhe shtoi se edhe këta janë me përgjegjësi, ngase në njëfar mënyre lejojnë shkeljen e ligjit. **Ahmet Zejnullahu** u përgjigj : pse tash kryetari i komunës nuk i tregon kompetencat, sepse i ka vetë, dhe ripërsëriti : “shpërndarja e kompetencave na ka shkaktuar probleme të mëdha, çka mund të them unë kur ne (APK) i përgadisim gjërat ndërsa ata (komunat) nuk veprojnë”. **Shaip Muja** potencoi (me humor) komunat me pyjet më të dëmtuara ku vepron LDK, Podujeva, Malisheva, Vitija.

Kryetari Fikrim Damka falënderoi të ftuarit duke shpresuar që shpejt do të dërgohet në parlament ligji i potencuar dhe ftoi komisionin më 5 qershor të prezantoi në SIRIUS sipas ftesës së KDI rreth temës së pyjeve.

5.Të ndryshme

Në pikën të ndryshme Kryetari njoftoi për shkresën e dërguar nga Kryesuesja e Komisionit shqyrtues **Sabrije Abazi** e cila kërkon sqarime nga Komisioni për emërimin e sajë në Komisionin shqyrtues në ZRRUK.

Komisioni përcjelli kërkesën e cekur Sekretarit të Kuvendit në kompetencën e mëtejme.

Mbledhja përfundoi në orën 13,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Fikrim Damka